



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 36/2018 (JR)
Nr. 36/2 regj.

Tiranë, më 19.06.2019

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën **e enjte, në datën 11.07.2019, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 36/2018, datë 04.12.2018, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr.61, datë 02.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Gentjan Osmani.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjyqësor
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtar

Natasha Mulaj
Ina Rama
Rezarta Schuetz
Albana Shtylla
Ardian Hajdari

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

KRYESUES I TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

NATASHA MULAJ

RELATORE E ÇËSHTJES
GJYQTARE

INA RAMA

